

ACMS X SCORP
FUSHATA 0 DISKRIMINIM
|
DISKRIMINIMI NDAJ
GRAVE

ÇFARË ËSHTË? KU NDODH? SI TA LUFTOJMË?

Përmbajtje

1. Çfarë është diskriminimi?
2. Diskriminimi i grave në shoqëri.
3. Diskriminimi i grave në familje.
4. Diskriminimi i grave në punë.
5. Diskriminimi i grave në instanca shtetërore.
6. Pasojat e diskriminimit.
7. Çfarë mund të bëjmë ne?



Qëllimi i këtij libërthi

- Ndërgjegjësimi ndaj diskriminimit dhe padrejtësive që hasen çdo ditë nga gratë dhe vajzat.
- Informimi i hollësishëm mbi efektet shoqërore, ekonomike dhe psikologjike që shkakton diskriminimi ndaj grave dhe vajzave.
- Hapat e menjëhershëm që mund të ndërmerren për të parandaluar këtë fenomen dhe për të mbështetur gratë dhe vajzat.



Krijimi dhe editimi:

Blerina Vidhishta

Dejsa Sula

Erisa Osmani

Kiara Lamaj

Loreta Shehaj

Nensi Qemalli

Stela Haxhimali

Xhuliana Kaloshi



Kujt i drejtohet ky libërth?

- 1.**Individëve vajza/gra që kanë rënë pre e një padrejtësie në shoqëri, institucione arsimore apo vend pune bazuar në stereotipin e gjinisë së tyre dhe jo në bazë të aftësive të tyre dhe përgatitjes së tyre profesionale.
- 2.** Vajzave dhe grave, të cilat janë ngacmuar dhe sulmuar personalisht në mënyrë verbale, fizike apo seksuale.
- 3.** Vajzave dhe grave, të cilave iu është privuar e drejta e fjalës, konkurimit, bashkëpunimit në vendin e punës, në mënyrë të padrejtë.
- 4.** Vajzave dhe grave, të cilat për shkak të veprimeve të kësaj natyre, janë ndjerë të poshtëruara, të sulmuara dhe të pafuqishme për të folur apo për t'u mbrojtur.

Kujt i drejtohet ky libërth?

5. Vajzave dhe grave, të cilat janë kërcënuar me dhunë verbale ose fizike në rast të ankimit apo denoncimit të veprimeve të natyrës diskriminuese të përshkruara në këtë libërth.
6. Vajzave dhe grave, të cilat nuk janë në dijeni të institucioneve apo departamenteve ku mund të drejtohen në rastet kur dëshmojnë apo bien pre e një sjelljeje diskriminuese nga një person i dytë ose grup njerëzish.
7. Individëve të interesuar të mësojnë më shumë mbi këtë temë.

Çfarë është diskriminimi?

Diskriminimi është akti i nxjerrjes në pah të dallimeve të pajustificuara midis qenieve njerëzore bazuar në grupe, klasa ose kategori të tjera në të cilat mendohet se përkasin. [1]

Njerëzit mund të diskriminohen në bazë të racës, gjinisë, moshës, fesë ose orientimit seksual, si dhe kategorive të tjera. [2] Diskriminimi ndodh veçanërisht kur individët ose grupet trajtohen padrejtësisht në një mënyrë më të keqe sesa trajtohen njerëzit e tjerë, në bazë të anëtarësimit të tyre aktual ose të perceptuar në grupe ose kategori të caktuara shoqërore. [2] [3]

Ai përfshin kufizimin e anëtarëve të një grupi nga mundësitë ose privilegjet që janë në dispozicion të anëtarëve të një grupi tjetër. [4]

P.s.: Për të mos kontribuar në thellimin e mëtejshëm dhe nxitjen e veprimeve diskriminuese, termat "mashkull"/ "femër" janë zëvendësuar me "burra"/ "djem" dhe "gra"/ "vajza".

Diskriminimi i femrave në shoqëri

Barazia dhe mbrojtja nga diskriminimi janë parime që përshkojnë të drejtën ndërkombëtare dhe legjislacionin tonë të brendshëm për të drejtat e njeriut. Por, edhe pse barazia është një komponent thelbësor i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, pabarazitë gjinore vazhdojnë të jenë prezente në shoqërinë tonë. Një nga shkeljet më të rënda të barazisë gjinore është dhuna ndaj grave. Dhuna ndaj gruas është një formë e diskriminimit e cila i ka rrënjët në pabarazinë gjinore dhe e përforcon atë. Në aktet ndërkombëtare në nivelin e OKB, nivelin e Këshillit të Europës dhe të drejtës së BE përfshihen akte që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte me barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin. Konventa CEDAW është një nga aktet ndërkombëtare më të rëndësishme në fushën e barazisë gjinore, e ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin nr. 7767, datë 9.11.1993.



Problemet kryesore

1. Gratë dhe vajzat cilësohen si të “paafta” në fushën e të mirave dhe shërbimeve ku përballen me pabarazi dhe forma të drejtpërdrejta e të tërthorta diskriminimi. Diskriminimi në ofrimin e shërbimeve, furnizimi me ujë të pijshëm dhe energji elektrike si dhe dispozitat mbi “klientin familjar” ku pjesa më madhe e të punësuarve janë burra. Për këtë qëllim KMD i ka dërguar rekomandim kompanisë CEZ Shpërndarje Sh.a, për rishikimin e kontratës tip, me qëllim shmangien e trajtimit të pabarabartë mes burrave dhe grave në ofrimin e shërbimit të furnizimit me energji elektrike [13]. Përmes këtij rekomandimi, KMD synon që vendimet që janë marrë në lidhje me çështjen konkrete, të kenë një rëndësi strategjike dhe të ndryshojnë jo vetëm situatën në të cilën ndodhet një grua, por situatën e grave dhe vajzave si grup gjinor.



2. Akses i grave në përfitimet nga skemat sociale dhe ekonomike, lë për të dëshiruar. Vitet e fundit janë ndërmarrë masa pozitive për fuqizimin e grave, kryesisht në sektorin ekonomik. Megjithatë vihet re se sa më të mëdha bëhen ndërmarrjet, aq më shumë ulet përqindja e grave që i drejtojnë ato. Vetëm 14,4% e ndërmarrjeve me 50 e më shumë të punësuar menaxhohen nga gratë, ndërkohë që 29% e ndërmarrjeve me 1-4 punëtorë drejtohen nga gratë, që përgjithësisht janë dyqane veshjesh, ose tregtimi ushqimor, parukeri, estetikë etj.[2]

3. Në disa vende të botës ku patriarkati i ka rrënjët ende të fuqishme, diskriminimi dhe dhuna ndaj grave është pjesë e mendësisë së tyre.

Në totalen e analizës, diskriminimi me bazë gjinore i orientuar mbi gratë, mbetet një temë shqetësuese për ndryshimin dhe përmirësimin e të cilës bashkëpunimi është domosdoshmëri.

Diskriminimi i grave në familje

Bazuar në formulime dhe interpretime sociologjike, **familja** konsiderohet qeliza themelore e shoqërisë. Në të nis baza edukative dhe formësimi i personalitetit të çdo individi, përfshirë vajzat.

Pavarësisht konventave të ratifikuara ndërshtetërore, ligjeve kombëtare në fuqi dhe përpjekjeve të shoqërive civile për përforcimin e roleve të barabarta të dy gjinive, diferencat në përgjegjësitë e marra dhe liritë e ofruara brenda familjes janë tepër të dukshme.

